



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 46/3 Prot.

Tiranë, më 08.01 2026

VENDIM

Nr. 3 dt. 08.01 2026

**“PËR
MIRATIMIN E PËRCJELLJES SË DOSJES SË KANDIDATIT PROF.ASC.DR.JUEL
JARANI PËR FITIMIN E TITULLIT “PROFESOR ” PRANË KPPA-SË”**

Në zbatim të nenit 38, 61, 79 pika 7 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, kreut IV pika 1 dhe 2 të Vendimit nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, nenit 20, 27 të Statutit të UST-së, nenit 7 të Rregullores së UST-së, nenit 21 dhe 24 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, mbështetur në shkresën nr. 2848/13 Prot., datë 19.12.2025 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes “Përcjellje e dokumentacionit për fitimin e titullit akademik “Profesor” të Prof.Asc.Dr. Juel Jarani”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.01.2026,

V E N D O S I :

1. Të miratojë përcjelljen e dosjes së kandidatës , për fitimin e titullit akademik “Profesor” pranë Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së.
2. Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik të vijojë me procedurat sipas kuadrit ligjor në fuqi.
3. Një kopje e këtij Vendimi i përcillet Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Dixhitalizimit të Sherbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

